Vendim nr. 281, datë 31.07.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 31.07.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (M) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **MAKSIM alias MAKS NDOCI,** përfaqësuar nga avokati Ardian Visha me akt përfaqësimi.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 1, datë 11.01.2025 dhe nr. 4, datë 13.01.2025 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 8, datë 17.02.2025 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-1099, datë 01.07.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" e 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 4 i Protokollit nr. 7 të saj; nenet 27, 49, pika 3, shkronja "e", 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë (*Prokuroria e Posaçme*) ka regjistruar procedimin penal nr. 296, datë 26.11.2021 (*procedimi penal nr. 296/2021*) për veprat penale "Trafikimi i narkotikëve", në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuara nga nenet 283/a, 28, pika 4 dhe 333/a të Kodit Penal (*KP*).

2. Regjistrimi i këtij procedimi penal është kryer mbi bazën e materialit të përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Firences, Drejtoria e Distriktit Antimafia nëpërmjet Zyrës Italiane të Eurojust, për procedimin penal nr. 9740/21 RGNR mod. 2.1., që ka të bëjë me hetimet për veprën penale të trafikimit të lëndëve narkotike të llojit "kokainë", të menaxhuar nga një organizatë kriminale shqiptare. Duke qenë se ka rezultuar se organizata kriminale organizon trafikim të paligjshëm të substancave narkotike, autoritetet italiane kanë kërkuar regjistrimin e një procedimi penal dhe krijimin më pas të një skuadre hetimore të përbashkët, me qëllim hetimin e grupit kriminal që zhvillonte aktivitetin në të dyja vendet. Nga hetimet e kryera në kuadër të skuadrës së përbashkët hetimore janë mbledhur elemente që provojnë ekzistencën e një grupi të strukturuar kriminal, me qëllim trafikimin e lëndës narkotike (në formën e importimit dhe më pas shpërndarjes në tregun italian kryesisht të kokainës), i cili ka si anëtarë të tij shtetas italianë dhe shqiptarë, mes të cilëve edhe kërkuesin Maksim Ndoci. Nga ana e autoriteteve gjyqësore italiane është kërkuar ndjekja penale edhe për kërkuesin, si pjesë e grupit të strukturuar kriminal, me qëllim kryerjen e trafikimit të sasive të mëdha të kokainës në portin e Livornos të ardhura nga Ekuadori, të destinuara për eksponentë të grupeve të shumta kriminale.

3. Në kuadër të hetimeve për procedimin penal nr. 296/2021, Prokuroria e Posaçme ka paraqitur në gjykatë kërkesë për caktimin ndaj kërkuesit të masës së sigurimit personal "Arresti në burg", si i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Trafikimi i narkotikëve", në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga nenet 283/a, 28, pika 4 dhe 333/a, si dhe "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grup i strukturuar kriminal", të parashikuar nga neni 334 i KP-së.

4. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), me vendimin nr. 1, datë 11.01.2025, ka pranuar kërkesën e prokurorisë, duke caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit personal "Arresti në burg", të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Sipas asaj gjykate, në kushtet kur kërkuesi ka dhënë pëlqimin për ekstradimin e thjeshtuar dhe në kushtet kur emri i tij është regjistruar si person nën hetim për procedimin penal nr. 296/2021, sipas prokurorisë ekziston rreziku që masa e sigurimit e përkohshme ndaj tij të revokohet duke pasur një rrezik të shtuar ikjeje. Në përfundim, ajo gjykatë ka vlerësuar se kërkuesi, si person nën hetim, ka nevojë të sigurohet, duke iu caktuar një masë sigurimi personal, për të garantuar vijimisht prezencën e tij si i dyshuar në procedimin penal në ngarkim të tij, për të siguruar normalitetin e hetimit dhe të gjykimit të çështjes, si dhe për të siguruar që ai të mos largohet, të fshihet, por t'i nënshtrohet ekzekutimit (vuajtjes) të dënimit kur vendimi i dënimit të ketë marrë formë të prerë. Ekzekutimi i masës së sigurimit është bërë për kërkuesin në datën 12.01.2025. Me vendimin nr. 4, datë 13.01.2025, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka disponuar vijimin e masës së sigurimit "Arresti në burg" ndaj kërkuesit. Kundër këtyre vendimeve ka bërë ankim kërkuesi.

5. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 8, datë 17.02.2025, ka vendosur miratimin e vendimeve nr. 1, datë 11.01.2025 dhe nr. 4, datë 13.01.2025 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke arsyetuar se masa e sigurimit e caktuar ndaj kërkuesit është më proporcionalja dhe më e përshtatshmja, duke pasur parasysh shkallën e nevojave të sigurimit, si dhe rëndësinë e fakteve dhe sanksioneve të parashikuara për veprat penale që i atribuohen atij. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1099, datë 01.07.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Sipas tij, gjykata e apelit ka argumentuar vendimmarrjen e saj, duke analizuar llojin e masës së caktuar në raport me parimin e përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit, sipas kërkesave të nenit 229 të KPP-së; nuk janë evidentuar shkelje që kanë sjellë pavlefshmëri absolute të vendimit; nuk janë parashtruar shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit apo se vendimi objekt rekursi vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në vlerësimin e Kolegjit Penal shumica e pretendimeve që ka paraqitur kërkuesi në rekurs lidhen me zbatimin e neneve 228, 229 dhe 230 të KPP-së, të cilat janë

vlerësuar nga gjykatat e faktit në raport me ekzistencën e kushteve dhe kritereve për caktimin e masës së sigurimit personal, si dhe të provave të paraqitura nga organi i akuzës. Sipas Kolegjit Penal, gjykata e apelit u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të ngritura nga kërkuesi.

7. Në datën 15.01.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

8. Kolegji i Gjykatës, gjatë shqyrtimit paraprak të ankimit kushtetues, konstatoi mungesën e akteve të nevojshme për verifikimin e plotësimit të kritereve të legjitimimit të kërkuesit dhe, me vendimin e datës 03.04.2026, duke pasur parasysh natyrën e pretendimeve të parashtruara, vendosi kthimin e kërkesës për plotësim. Në datën 10.07.2026 kërkuesi paraqiti në Gjykatë kopje të përkthyer zyrtarisht në gjuhën shqipe të vendimit nr. 9740/21 R.G.N.R., datë 13.01.2026 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Firences.

II

Pretendimet e kërkuesit

9. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

9.1. *Liria personale*, sipas neneve 27 dhe 28 të Kushtetutës dhe 5 të KEDNJ-së, pasi:

9.1.1. Ndaj kërkuesit rëndojnë dy masa sigurimi personal, ajo për qëllime të ekstradimit dhe ajo e dhënë në kuadër të procedimit penal nr. 296/2021 të regjistruar nga Prokuroria e Posaçme. Në këtë mënyrë kërkuesi privohet nga e drejta për të marrë pjesë dhe për t'u dëgjuar në procesin penal italian, si dhe ndodhet në pamundësi absolute të ushtrimit të të drejtave të tij procedurale për pranim-pendimin si rrethanë lehtësuese dhe kërkimin formal të ritit privilegjues të procesit. Kërkuesi ka dhënë pëlqimin për t'u ekstraduar, me qëllim pjesëmarrjen në procedimin penal të huaj, por kjo e drejtë pamundësohet për shkak të masës së sigurimit të kundërshtuar, të caktuar për të njëjtat fakte. Për më tepër, pozita e kërkuesit është rënduar pasi dënimi i parashikuar nga legjislacioni italian është më i ulët sesa ai shqiptar për veprën konkrete.

9.1.2. Gjykata e Lartë nuk ka shqyrtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë faktin se ndaj kërkuesit po zhvillohet një procedim penal paralel në Shqipëri, ndërkohë që për të njëjtin fakt penal është lejuar ekstradimi i tij drejt shtetit italian. Në kushtet kur ekstradimi i kërkuar nga autoritetet italiane është zgjidhur përfundimisht dhe është

pranuar nga vetë kërkuesi, eliminohet çdo rrezik ikjeje ose shmangieje nga drejtësia. Gjykata e Lartë ka vepruar në mënyrë mekanike dhe formale duke mos zbatuar detyrimin për të vlerësuar domosdoshmërinë e masës dhe proporcionalitetin e saj. Në kushtet kur kërkuesi ndodhet përballë dy autoriteteve gjyqësore që e ndjekin penalisht për të njëjtën ngjarje/vepër dhe pa justifikim të drejtë të nevojës për të dyfishuar ndjekjen, Gjykata e Lartë ka legjitimuar situatën e pasigurisë për kërkuesin.

9.2.*E drejta për proces të rregullt*, sipas neneve 42 të Kushtetutës dhe 6 të KEDNJ-së, në drejtim të:

9.2.1. *Standardit të arsyetimit,* pasi Kolegji Penal nuk ka kontrolluar ligjshmërinë e vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe nuk ka shqyrtuar pretendimet e kërkuesit për shkeljet procedurale dhe materiale të ligjit penal, duke dhënë një vendim me arsyetim të pamjaftueshëm dhe kontradiktor. Në ndryshim nga sa ka çmuar ai kolegj, pretendimet e ngritura në rekurs nuk lidhen me rivlerësimin e provave, por me vlerësimin e kushteve ligjore për caktimin e masës së sigurimit personal, çka është kompetencë e asaj gjykate, ndaj ajo ishte e detyruar të shqyrtonte ligjshmërinë e caktimit të masës së sigurimit.

9.2.2. *Parimit ne bis in idem*, pasi fashikulli hetimor i paraqitur nga Prokuroria e Posaçme është i prejardhur tërësisht nga autoritet gjyqësore italiane dhe përmban absolutisht të njëjtin fakt penal e prova për të cilat ato autoritete janë duke e gjykuar kërkuesin, duke mos u shtuar asgjë që do të kontribuonte në rëndimin e formës së bashkëpunimit kriminal të atribuar atij. Episodi kriminal i atribuar kërkuesit është konsumuar në territorin italian dhe për këtë fakt penal autoritetet italiane jo vetëm nuk kanë kërkuar transferimin e procedimit, por kanë vijuar me gjykimin e kërkuesit, duke u ndodhur aktualisht në fazën e marrjes së vendimit nga Gjykata e Firences, për disponimin e të cilit është caktuar data 13.01.2026. Këto fakte pamundësojnë procedimin ose dënimin e kërkuesit për herë të dytë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesit

10. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, ndaj, në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kritereve të legjitimimit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkuesin. Po kështu, mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së tyre, me pasojë moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kritereve të tjera. Mbi këtë bazë Kolegji vlerësoi të ndalet vetëm në analizën e kriterit të legjitimimit *ratione materiae* të kërkuesit.

12. Kolegji, në këndvështrim të përmbushjes së kriterit të legjitimimit *ratione materiae* të kërkuesit, i cili verifikohet në drejtim të natyrës dhe thelbit të pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues, vëren se pretendimet e kërkuesit të parashtruara në ankimin kushtetues individual për cenimin e *lirisë personale* dhe të parimit *ne bis in idem*, në thelb, mbështeten mbi faktin e ekzistencës së një procedimi tjetër penal në shtetin italian, i cili, sipas tij, bazohet mbi të njëjtat fakte penale si ato të procedimit penal në kuadër të të cilit është vendosur masa e kundërshtuar e sigurimit. Sipas kërkuesit, procedimi penal në Itali është në fazën e vendimmarrjes dhe Gjykata e Firences ka caktuar datën për dhënien e vendimit për themelin e akuzave penale. Po kështu, ai ka pretenduar se ka pranuar edhe ekstradimin e thjeshtuar, me qëllim ekstradimin e tij drejt shtetit italian. Më konkretisht, për sa i takon *lirisë personale*, kërkuesi ka pretenduar se është cenuar për 2 arsye: (i) për shkak të pamundësisë për të marrë pjesë në procedimin penal që po zhvillohet në Itali si rezultat i masës së sigurimit që është vendosur mbi të në Shqipëri, zbatimi i

së cilës pengon ekstradimin për të cilin kërkuesi ka dhënë pëlqimin; (ii) për shkak të mosshqyrtimit nga Gjykata e Lartë të faktit se ndaj kërkuesit po zhvillohet një procedim penal paralel në Shqipëri. Ndërsa për sa i takon parimit *ne bis in idem*, kërkuesi ka pretenduar se është cenuar për shkak të faktit se ai po procedohet penalisht për të njëjtin fakt penal në të dyja juridiksionet, atë shqiptar dhe atë italian.

13. Kolegji vëren, fillimisht, se gjatë shqyrtimit paraprak të këtij ankimi kushtetues, për shkak se konstatoi mungesën e akteve të nevojshme për verifikimin e plotësimit të kriterit të legjitimimit *ratione materiae*, me vendimin e datës 03.04.2026, në mbështetje të nenit 31, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës, vendosi kthimin e kërkesës për plotësim, duke kërkuar nga kërkuesi paraqitjen e akteve që provojnë: i) fazën në të cilën ndodhet aktualisht procesi penal ndaj tij në shtetin italian; ii) nëse plotësohet kushti i dytë i nenit 228 të KPP-së, konkretisht nëse ekzistojnë shkaqe të padënueshmërisë së kërkuesit si subjekt i dyshuar ose të shuarjes së veprave penale të atribuara atij; iii) kopjen e vendimit gjyqësor që ka lejuar ekstradimin e kërkuesit. Në datën 10.07.2026 përfaqësuesi i kërkuesit ka paraqitur në Gjykatë vetëm një kopje të vendimit gjyqësor nr. 9740/21 R.G.N.R., akti datë 13.01.2026 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Firences, Itali me të cilin kërkuesi është deklaruar fajtor për veprën penale të parashikuar nga nenet 110 të KP-së Italiane, 73, paragrafi I-bis dhe 80, paragrafi II, të dekretit presidencial nr. 309/90 si përgjegjës për rikuperimin e narkotikëve, në bashkëpunim me persona të tjerë ende të paidentifikuar, duke e dënuar atë me 4 vjet burgim dhe gjobë në vlerën 18.000 euro.

14. Në këndvështrim të përmbushjes së këtij kriteri, i cili verifikohet në drejtim të natyrës dhe thelbit të pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues, Kolegji vëren se pretendimet për cenimin *e lirisë personale* kërkuesi i ka lidhur me ekzistencën e një mase tjetër sigurimi, të dhënë nga gjykata në kuadër të procesit të ekstradimit të kërkuar nga autoritetet italiane, për të cilin vetë kërkuesi ka dhënë pëlqimin, me qëllim marrjen pjesë personalisht në procesin penal që po zhvillohet ndaj tij në shtetin italian. Sipas kërkuesit, ekstradimi i tij në shtetin italian është bërë i pamundur për shkak të masës së sigurimit të kundërshtuar, të dhënë në kuadër të procedimit penal të regjistruar në shtetin shqiptar.

15. Sipas nenit 27, pikat 1 dhe 3, të Kushtetutës, askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj, ku në pikën 2, shkronja "dh", të kësaj dispozite parashikohet si i tillë edhe rasti i ekstradimit. Ndërkohë që në nenin 28 të Kushtetutës janë përcaktuar garancitë dhe të drejtat që i njihen personit të cilit i hiqet liria. Për sa i përket

ekstradimit jashtë territorit të vendit ai rregullohet nga neni 39, pika 2, i Kushtetutës, sipas të cilit mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë dhe vetëm me vendim gjyqësor. Më tej, marrëveshjet ndërkombëtare shumëpalëshe dhe dypalëshe të ratifikuara, KP-ja dhe KPP-ja, si dhe ligji i posaçëm nr. 10193, datë 03.12.2009 "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale" (*ligji nr. 10193/2009*) parashikojnë parimet dhe rregullat e zbatueshme në rast ekstradimi. Gjykata ka theksuar se procesi i ekstradimit për jashtë shtetit ka natyrë të dyfishtë, duke qenë pjesërisht administrativ, për sa i përket veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë dhe pjesërisht gjyqësor, pasi ai mund të lejohet vetëm me vendim gjyqësor, ku në rastin e lejimit është ministri i Drejtësisë ai që disponon përfundimisht për ekstradimin ose jo të një shtetasi (*shih vendimin nr. 2, datë 14.01.2026 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i përket ekstradimit të thjeshtuar, sipas nenit 44 të ligjit nr. 10193/2009, ai nënkupton se personi për të cilin kërkohet ekstradimi mund të japë pëlqimin që të dorëzohet vetë te shteti kërkues dhe për heqjen dorë nga e drejta për të përfituar nga parimi i specialitetit përmes një procedure të thjeshtuar.

16. Kolegji vëren se kërkuesit, për shkak se në ankimin kushtetues ka pretenduar se ka dhënë pëlqimin për t'u ekstraduar në shtetin italian në përgjigje të kërkesës së autoriteteve italiane për këtë qëllim dhe se për këtë shkak ndaj tij rëndojnë dy masa sigurimi personal, njëra për qëllime ekstradimi dhe tjetra e caktuar në kuadër të procedimit penal nr. 296/2021, të regjistruar nga Prokuroria e Posaçme, iu kërkua plotësimi i kërkesës në këtë drejtim, me qëllim paraqitjen e vendimit që ka lejuar ekstradimin e tij. Pavarësisht detyrimit të kërkuesit, që ka barrën e provës në procesin kushtetues, i cili është i natyrës argumentuese, për të provuar pretendimet e tij të parashtruara përpara Gjykatës, ai nuk paraqiti asnjë akt provues të pretendimit të tij, sikundër asnjë parashtrim ose argument shtesë në lidhje me pranimin e kërkesës së autoriteteve italiane për ekstradimin e tij, me qëllim pjesëmarrjen personalisht në procedimin penal të huaj, ashtu edhe faktin se ndaj tij është caktuar ose është zbatuar një masë sigurimi për qëllime ekstradimi. Kolegji vëren se kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë ose argument në lidhje me ekzistencën, në kuptim të nenit 228 të KPP-së, e shkaqeve të padënueshmërisë ose të shuarjes së veprave penale të atribuara. Ndonëse një gjë e tillë i është kërkuar në mënyrë të qartë në vendimin për kthimin e kërkesës për plotësim, për sa kohë që kërkuesi nuk ka paraqitur akte provuese, pretendimi i tij mbetet i paprovuar, ndaj konsiderohet se është haptazi i pabazuar. Po kështu, kërkuesi nuk rezulton të ketë paraqitur ndonjë provë ose argumente as në drejtim të faktit, në këndvështrim të pretendimit

për cenimin e parimit *ne bis in idem*, se për të njëjtat vepra penale ai është dënuar me një vendim përfundimtar të juridiksionit italian (*shih më poshtë paragrafët 19 dhe 20 të vendimit*).

17. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* për shkak të mënyrës sesi gjykatat kanë verifikuar dhe zbatuar kriteret dhe kushtet për caktimin e masës së sigurimit. Për sa i përket proporcionalitetit të masës së sigurimit, sipas kërkuesit, në kushtet kur është pranuar ekstradimi i thjeshtuar, pra kjo çështje është zgjidhur përfundimisht, eliminohet çdo rrezik ikjeje ose shmangieje nga drejtësia. Sipas kërkuesit, është cenuar edhe parimi *ne bis in idem* që pamundëson procedimin ose dënimin e tij për herë të dytë, për shkak se faktet penale për të cilat është regjistruar procedimi penal nr. 296/2021 në Shqipëri, në kuadër të të cilit është caktuar edhe masa e sigurimit personal objekt i ankimit kushtetues, janë të njëjta me ato për të cilat ndaj tij ka nisur procedimi penal në shtetin italian. Sipas tij, episodi kriminal që i atribuohet është konsumuar në territorin e shtetit italian dhe Prokuroria e Posaçme nuk ka shtuar asgjë në fashikullin e përcjellë nga autoritetet italiane. Po sipas kërkuesit, për këtë fakt penal autoritetet italiane kanë vijuar me gjykimin e tij dhe procesi ndodhet në fazën e vendimmarrjes nga Gjykata e Firences, e caktuar në datën 13.01.2026.

18. Sipas nenit 34 të Kushtetutës "*askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe as të gjykohet sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj*". Gjykata ka pohuar se *ratio* i kësaj dispozite kushtetuese është sanksionimi i parimit "*të mosgjykimit dhe dënimit dy herë për të njëjtën vepër penale*" (*ne bis in idem*) dhe parimit të "*gjësë së gjykuar*" (*res judicata*), të cilat vijnë si garanci në kuadër të mbrojtjes të të drejtave të individit në fushën penale (*shih vendimet nr. 47, datë 05.10.2023; nr. 1, datë 26.01.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi *ne bis in idem* parashikon se askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht për një vepër penale për të cilën është shpallur më parë i pafajshëm ose është dënuar me një vendim përfundimtar, pra për të njëjtin fakt që përbën vepër penale, për të cilën ai është dënuar më parë me një vendim të formës së prerë nga një gjykatë e caktuar me ligj. *Kriteri "e njëjta vepër*" i referohet të njëjtit veprim, sjellje, fakt, vepër penale dhe kualifikim ligjor që formojnë bazën e kësaj vepre dhe për të cilën personi është dënuar ose liruar. Në këtë kuptim, Gjykata ka pohuar se nëse gjenden elemente të njëjta, parimi *ne bis in idem* ndalon çdo dënim tjetër ose procedim të mëtejshëm (*shih vendimet nr. 47, datë 05.10.2023; nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 33, datë 22.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në mbështetje të këtij pretendimi, pas kthimit të kërkesës për plotësim, kërkuesi ka paraqitur kopje të përkthyer zyrtarisht të vendimit penal nr. 9740/21 R.G.N.R. akti, datë 13.01.2026 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Firences, Itali, me të cilin është dënuar me 4 vjet burgim dhe gjobë në masën 18.000 euro vetëm për akuzën për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga nenet 110 të KP-së Italiane, 73, paragrafi I-bis dhe 80, paragrafi II, të dekretit presidencial nr. 309/90 si përgjegjës "*për rikuperimin e narkotikut në Livorno... në bashkëpunim me persona të tjerë ende të paidentifikuar, pasi kanë importuar në Itali, me qëllim dhënien e saj palëve të treta, 140.24162 kg neto kokainë nga Ekuadori, të ndara në 140 bukë të fshehura brenda kontenierit që udhëtonte me anijen "Mary" me itinerarin Guayaquil - Livorno, i mbërritur në datën 02.03.2022*". Sipas këtij vendimi kërkuesi është deklaruar i pafajshëm për akuzën për dy episode të tjera të trafikimit të narkotikëve të pretenduara nga prokuroria, pasi është vlerësuar se fakti penal nuk ekzistonte.

20. Për sa i përket këtij pretendimi, Kolegji vëren se vendimet e kundërshtuara në ankimin kushtetues për caktimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit janë dhënë në kuadër të procedimit penal të regjistruar në Shqipëri mbi bazën e materialit të përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Firences, Drejtoria e Distriktit Antimafia nëpërmjet Zyrës Italiane të Eurojust, për dyshimin se organizata kriminale ku dyshohet se bën pjesë edhe kërkuesi organizon trafikim të paligjshëm të substancave narkotike të llojit "kokainë". Në këto vendime gjykatat e zakonshme kanë evidentuar se aktiviteti hetimor i autoriteteve gjyqësore italiane dhe shqiptare është realizuar në kuadër të bashkëpunimit gjyqësor, si rezultat i të cilit janë mbledhur elemente që provojnë ekzistencën e grupit të strukturuar kriminal me qëllim trafikimin e lëndës narkotike, anëtarë të të cilit janë shtetas shqiptarë dhe italianë, të cilët e ushtrojnë aktivitetin kriminal në Itali. Po kështu, në këndvështrim të parimit *ne bis in idem*, Kolegji thekson se në mungesë të akteve provuese dhe argumenteve në këtë drejtim (*shih paragrafin 16 të vendimit*) vetëm kopja e vendimit të huaj (*vendimi i datës 13.01.2026 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Firences*), e paraqitur prej kërkuesit në përgjigje të kërkesës së Kolegjit për plotësimin e ankimit kushtetues, nuk provon faktin që për të njëjtat vepra penale ai është dënuar me një vendim përfundimtar të juridiksionit italian.

21. Nga ana tjetër, në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, Kolegji vlerëson se kufizimi i lirisë personale të kërkuesit është vendosur me vendim gjyqësor dhe mbi bazën e dyshimit se ai mund të ketë kryer veprat penale për të cilat procedohet. Ky dyshim i arsyeshëm nuk është mbështetur në vlerësime të përgjithshme ose abstrakte, por në të dhëna,

informacione dhe akte konkrete të administruara në atë fazë të procedimit, të cilat, në tërësinë e tyre, janë vlerësuar si të mjaftueshme për të krijuar një lidhje objektive midis kërkuesit dhe veprave penale për të cilat dyshohet. Arsyetimi i gjykatave të zakonshme në këtë drejtim nuk është abstrakt, por ato gjykata kanë shpjeguar në mënyrë konkrete dhe të mjaftueshme praninë e kritereve dhe kushteve që lejojnë kufizimin e lirisë personale. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë argumentuar arsyet të cilat kanë justifikuar kufizimin, duke shfaqur një kujdes të veçantë në këtë drejtim, si dhe përse kjo masë ishte masa më e përshtatshme për të arritur qëllimin për të cilën ishte kërkuar. Ato kanë analizuar jo vetëm dyshimin e arsyeshëm, të bazuar në prova, se kërkuesi mund të ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet, por edhe ekzistencën e kritereve të tjera që justifikojnë kufizimin e lirisë sipas nenit 228, pika 3, të KPP-së. Ato gjykata kanë verifikuar dhe arsyetuar edhe se nevojat e sigurimit nuk mund të plotësoheshin nga masa më të lehta sigurimi, duke argumentuar edhe se përse masa më e rëndë ishte e vetmja që plotësonte nevojat e sigurimit, referuar dinamikës së hetimit penal dhe rrethanave konkrete të pasqyruara dhe të provuara nga organi i akuzës. Për më tepër, gjykatat e faktit kanë arsyetuar në rastin konkret edhe në drejtim të moszbatimit në rastin e kërkuesit të parimit *ne bis in idem* për faktet e ndodhura në territorin italian, duke vlerësuar, mes të tjerash, edhe se ndaj kërkuesit nuk ka një vendim përfundimtar për fajësinë ose pafajësinë tij nga autoritetet gjyqësore italiane, pasi procesi penal në shtetin italian në kohën e dhënies së vendimeve të kundërshtuara, ndaj kërkuesit ishte ende në zhvillim. Edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në përputhje me kompetencat e tij, pasi ka marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në rekurs, ka dhënë përgjigje të arsyetuar se përse nuk janë të tilla që mund të cenojnë vendimin e gjykatës së apelit. Vetëm fakti që ajo gjykatë ka vendosur mospranimin e rekursit nuk është i mjaftueshëm në këndvështrimin kushtetues për të vënë në dyshim procesin e zhvilluar në atë gjykatë.

22. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuesit në drejtim të parimit *ne bis in idem* dhe *standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore* janë haptazi të pabazuara.

23. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.